

Përfaqësueset dhe Përfaqësuesit e Mediave

Detyra Juaj si gazetar/e

Rëndësia e mediave në politikë vjen gjithnjë e më rritje. Të dyja fushat lidhen gjithnjë e më ngushtë me njëra-tjetrën, nuk ka rëndësi në janë media të shkruara, televizion apo internet. Mediat në një sistem politik janë një lloj pushteti i katërt krahas legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. e njëjta gjë vlen edhe për BE:

Mediat kanë një pushtet të gjithëanshëm raportimi dhe informimi. Ky pushtet fuqizohet nga fakti që institucionet politike zor se mund të informojnë, pa llogaritur këtu broshurat në fushen e marrëdhënieve me publikun apo botimet jo aq tërheqëse për publikun sikundër janë fletoret zyrtare apo deklaratat për shtyp.

Përmes pranisë së tyre të vazhdueshme me shkrim, figurë dhe zë mediat janë aktorë të rëndësishëm në formimin apo ndryshimin e ndërgjegjes, dhe përmbushin kështu nga njëra anë një detyrë të rëndësishme për një politikë transparente në një sistem demokratik. Nga ana tjetër masmediat ndikojnë jo vetëm drejtpërsëdrejti në mendimet dhe pikëpamjet e njerëzve por përcaktojnë në mënyrë indirekte edhe vendimmarrjen politike. Në këtë mënyrë mediat marrin një dimension pothuaj politik, i cili - me një legjitimim të pakrahasueshëm - kërcënon të zëvendësojë dhe të bëjë mënjane aktorin Politikë.

Sipas Rolf Stober: Mediat si pushtet i katërt. Rreth përgjegjësisë së masmediave; në: Gerhard W. Wittkämper (Hrsg.): Mediat dhe politika. Darmstadt 1992, f. 28/

Shumë të nderuar/a redaktore/ë, shumë të nderuar/a reportere/ë televizive/ë!

Ju e dini që ditët dhe muajt e ardhshëm do të merren vendime të rëndësishme në lidhje me zgjerimin e Bashkimit Evropian me anëtarë të rinj. Për këtë periudhë kohore Ju do të liroheni nga cdo detyrim tjetër dhe do të mund t'i përkushtoheni kësaj teme. Si gazetar/e keni detyrën të informoni në lidhje me situatën, rrjedhën dhe bisedimet në kuadër të procesit të anëtarësimit. Me informacionet dhe komentet Tuaja do të përmbushni një detyrë të rëndësishme në trajtimin e ngjarjeve si për publikun e gjerë ashtu edhe për aktorët e vecantë pjesëmarrës në procesin e zgjerimit (institucionet dhe shtetet) duke sjellë kështu më shumë transparencë në një Evropë demokratike.

Caktoni ndarjen e detyrave të ndryshme në redaksitë Tuaja dhe vendosni se kur dëshironi të jeni të pranishëm në qendrat dhe instancat vendimmarrëse.

Në këto periudha kohore do të gjendeni në lokalitetet përkatëse për t'u tërhequr më pas në redaksitë Tuaja për bisedime dhe shkrimin e artikujve. Nëse është e mundur redaksia e një gazete apo e një kanali televiziv duhet të përbëhet nga të paktën dy persona. Mjetet që do të keni në dispozicion: videoregjistrator, kamera fotografik polaroid/dixhitale, videokamera, kompjuter, kënde për gazetën periodike te murit....

Jini të vetëdijshëm që me informimin Tuaj, me pyetjet dhe komentet Tuaja po edhe vetëm me praninë Tuaj, mund të ndikoni aktorët politikë dhe vendimet e tyre, dhe merrni përsipër këtë përgjegjësi.

Duke qenë gazetarë me përvojë Ju ofrohen mundësi të ndryshme për të mbledhur dhe shpërndarë informacione. Në këtë kontekst Ju mund të përqendroheni në format e gazetarisë bulevardeske apo të asaj serioze. Ofroni informim duke marrë në konsideratë shtresat dhe interesat e ndryshme të lexuesve në varësi të publikut të synuar:

Duhet

1. të intervistoni aktorët (anëtarë të Parlamentit Evropian dhe delegatë të vendeve kandidate);
2. të merrni pjesë në konferenca shtypi, që ofrohen nga aktorët, dhe të hartoni raporte, të prezantoni informacione dytësore dhe të formuloni pyetje që janë me interes për opinionin publik evropian;
3. të merrni pjesë në seancat publike të komisioneve të ndryshme;
4. të informoni në lidhje me bisedimet dhe të publikoni kontributet e tyre në një gazetë muri vazhdimisht të aktualizuar;
5. të përpiqeni të përfshini opinionin publik vendas (p.sh.përmes anketimeve në vendin ku zhvillohen mbledhjet apo në zonën e kalimtarëve);
6. që ekipi televiziv të regjistrojë bisedimet më të rëndësishme dhe të realizojë intervista. Dhe në mbyllje të Lojës Plan duhet të mund të shfaqni filmimin e përgatitur;
7. e mundshme është të realizohet edhe një emision live me raportime aktuale nga institucionet dhe vendet kandidate për anëtarësim si dhe një Talk-Show me politikanë. Kjo do të ishte me vend vecanërisht në momentin kur Këshilli tërhiqet për të marrë vendim dhe Parlamenti Evropian dhe përfaqësuesit e vendeve kandidate presin njoftimin e vendimit;
8. Në mbyllje duhet ofruar edhe një gazetë e shkurtër (me dy deri katër faqe) me rrjedhën e ngjarjeve dhe me rezultatet përkatëse për pjesëmarrëset dhe pjesëmarrësit;
9. Në vend të një gazete të shtypur mund të realizohet edhe një faqe interneti.

Ju urojmë shumë sukses në punën Tuaj në Bruksel, Strasburg dhe Luksemburg!

Editori Juaj